1- **Pagesa e kartës**, ju mund të bëni pagesën e detyrimit të kartës manualisht duke zgjedhur:

- shumën totale të detyrimit (nëse klikoni këtu, automatikisht do të shfaqet shuma e mbetur e detyrimit të kartës së zgjedhur)
- shumën minimale (nëse klikoni këtu, automatikisht do të shfaqet shuma minimale e detyrimit të kartës së zgjedhur)
- ose një shumë tjetër (ku duhet të vendosni sipas dëshirës manualisht shumën e pagesës)

Nëse doni të kryeni pagesë manuale ndiqni hapat e mëposhtme:

- Zgjidhni nga lista e kartave të kreditit, kartën për të cilën do të kryhet pagesa, Klikoni **PAGESË MANUALE**
- Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të merret pagesa e kartës
- Zgjidhni **Shuma minimale e ngjellur** (nëse doni të kryeni minimumin e detyrimit)
- Zgjidhni **Shuma e ngjellur** (nëse doni të kryeni detyrimin total të kartës së kreditit)
- Shënoni direkt një **Shumë** në kutinë përkatëse (nëse doni të kryeni një shumë të ndryshme nga minimumi ose totali i detyrimeve të kartës së kreditit)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse ka) për të kryer këtë pagesë, dhe më pas klikoni **PAGUAJ** dhe në faqen konfirmuese mund të zgjidhni

nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike

- klikoni VAZHDO për të kryer pagesën

Pagesa e kartës së kreditit e kryer nëpërmjet Degës Internet aktivizohet në moment.

2- **Pagesë automatike**, ju mund të Zgjidhni që automatikisht nga llogaria juaj të mbahet:

- shuma minimale, ose
- shuma totale e kartës suaj të kreditit

Nëse doni të kryeni pagesë automatike ndiqni hapat e mëposhtem:

- Zgjidhni nga lista e kartave të kreditit, kartën për të cilën do të kryhet pagesa, Klikoni NDRYSHO PAGESËN AUTOMATIKE
- Zgjidhni **Shuma Minimale** (nëse doni që të autorizoni bankën që të kryej automatikisht në datën e fundit të pagesës, shumën minimale të detyrimit të kartës suaj të kreditit), ose
- Zgjidhni **Shuma Totale** (nëse doni që të autorizoni bankën që të kryej automatikisht në datën e fundit të pagesës, shumën totale të detyrimit të kartës suaj të kreditit), më pas klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese VAZHDO për të aktivizuar këtë kërkesë

10.3 Paradhënie

Këtu ju mund të transferoni limitin e *paradhënies nga karta juaj e kreditit në llogarinë tuaj rrjedhëse duke:

- Zgjedhur nga lista e kartave të kreditit, kartën nga e cila do të kryhet paradhënia,
- Zgjidhni llogarinë në të cilën do të kalohet paradhënia
- Klikoni **Limiti Maksimal i Paradhënies** (nëse doni të kaloni këtë limit në llogarinë e Zgjedhur)
- Klikoni **Limiti Mbetur** (nëse doni të kaloni këtë limit në llogarinë e Zgjedhur)
- Vendosni manualisht një **Shumë tjetër** (nëse doni të kryeni një shumë më të ulët se limiti i paradhënies),
- Klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike, klikoni VAZHDO për të kryer veprimin

***Limiti i paradhënies nga karta e kreditit është 10% e limitit total të kartës së kreditit të aprovuar nga dega, i cili mund të përdoret për tërheqje në ATM, etj.**

Kalimi i tërheqjes nga karta në llogarinë e Zgjedhur aktivizohet në moment.

10.4 Ndarje me këste



Këtu ju mund të ndani me këste një transaksion të kryer në një POS jo të BKT ose një transaksion të kryer në internet. Këtu do ju shfaqet lista e ofertave bashkë me transaksionet që përmbushin kushtet e ofertave të ndryshme. Nëse doni të ndani një transaksion me këste ndiqni hapat e mëposhtme:

- Zgjidhni nga lista e ofertave, ofertën që doni ose ju duket më e përshtatshme për ju
- Nga lista e transaksioneve që përmbushin kushtet për ofertën e Zgjedhur, zgjidhni transaksionin që doni të ndani me këste dhe kliko "Vazhdo" në faqen konfirmuese mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike dhe klikoni VAZHDO për të përfunduar veprimin

10.5 Paguaj Kartë tjetër

Nëse doni të kryeni pagesën e një karte tjetër të lëshuar nga BKT ndiqni hapat e mëposhtme:

- Vendosni numrin e plotë të kartës dhe klikoni VAZHDO
- Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të merret pagesa e kartës
- Vendosni shumën që doni të paguani
 - Zgjidhni nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse ka) për të kryer këtë pagesë,
 - Në faqen konfirmuese mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike
- Klikoni VAZHDO për të kryer veprimin

Pagesa e kartës së kreditit e kryer nëpërmjet Degës Internet aktivizohet në moment.

10.6 Aplikim për Kartë

Këtu mund të bëni aplikim për një kartë të re krediti, duke:

- Plotësuar Emrin e plotë mbi kartë
- Zgjidhni tipin e kartës që doni nga lista (Master/ Visa)

- Zgjidhni formën e kartës që doni nga lista (Kryesore/ Dytësore)
- Vendosni numrin tuaj të telefonit ku doni të kontaktoheni
- Klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese klikoni VAZHDO për të dërguar kërkesën tuaj

10.7 Limiti në Internet

Këtu mund të aktivizoni ose ndryshoni përqindjen e limitit të kartës së kreditit për blerje në internet, nga 0%-100% të limitit total të kartës së kreditit duke:

- Zgjedhur nga lista e kartave të kreditit, kartën për të cilën do të kryhet ndryshimi i përqindjes,
- Vendosni vlerën e re të limitit, klikoni VAZHDO
- Në faqen konfirmuese shihni me kujdes të dhënat e veprimit dhe klikoni VAZHDO
- Konfirmoni të dhënat e kartës duke:
 - o Zgjedhur kartën nga lista
 - o Vendosni Kodin PIN të kartës së Zgjedhur
 - o Klikoni KONFIRMO për të përfunduar me ndryshimin e limitit

Limiti i ndryshur nëpërmjet Degës Internet aktivizohet në moment.


11 TRANSFERTAT

Nëse klikoni tek Menu **Transferrat** do ju shfaqen 6 nënmenu:

1. Mes llogarive të mia
2. Brenda BKT
3. Brenda vendit
4. Ndërkombëtare
5. Transferta të regjistruara
6. Historiku i transfertave

11.1 Mes llogarive të mia

Këtu ju mund të kryeni transfertat mes llogarive tuaja që keni në BKT brenda të njëjtës monedhë.



Zgjidhni që kjo menu të shfaqet direkt tek menutë e preferuara

Këtu gjeni një përshkrim mbi këtë menu

Zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma

Mund të zgjidhni që të përdorni limitin e overdraftit ose jo (nëse keni)

Vendosni shumën e transfertës


Përshkrimi i transfertës (nëse doni)

Zgjidhni nga lista llogarinë tek e cila do të dërgohet shuma

Transferrat mes llogarive janë aktive që në momentin e kryerjes.

11.2 Brenda BKT

Këtu ju mund të bëni transfertë brenda llogarive të hapura në BKT për çdo klient të BKT, brenda të njëjtës monedhë:



Zgjidhni që kjo menu të shfaqet direkt tek menutë e preferuara

Këtu gjeni një përshkrim mbi këtë menu

Zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma

Tipi transfertës

Mund të zgjidhni që të përdorni limitin e overdraftit ose jo (nëse keni)

Këtu vendosni të dhënat e llogarisë, në të cilën doni të bëni transfertën

Detaje të Transfertës


Regjistrim të dhënash

- **Transfertë në Llogari** (duhet zgjedhur kur kryeni për herë të parë një transfertë)
- **Transfertë e regjistruar** (mund ta zgjidhni nga lista nëse keni kryer më parë transfertë në të njëjtin numër llogarie)

Transfertat brenda BKT janë aktive që në momentin e kryerjes.

11.3 Brenda Vendit

Këtu ju mund të kryeni transferta nga llogaria juaj drejt një llogarie tjetër të hapur në një bankë tjetër të nivelit të dytë brenda Shqipërisë, në të njëjtën monedhë. Për këtë trasfertë ju duhet të keni kodin IBAN të llogarisë pritëse.



The screenshot shows the 'Transfertë Brenda Vendit' (Intra-Bank Transfer) interface. Key elements and annotations include:


- Tipi i Transfertsës**: A callout pointing to the transfer type selection area, which includes 'Transfertë drejt llogarisë' and 'Transfertë e Regjistruar'.
- Zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma**: A callout pointing to the dropdown menu for selecting the source account.
- Mund të zgjidhni që të përdorni limitin e overdraftit ose jo (nëse keni)**: A callout pointing to the checkbox for using the overdraft limit.
- Plotësoni të dhënat mbi llogarinë ku do të kryhet transferta**: A callout pointing to the recipient account details section, including fields for bank name, IBAN, and account number.
- Përzgjidhni mënyrën e pagesës së komisioneve (nëse do këtë)**: A callout pointing to the 'Detyrimet' (Fees) section, where users can select how fees are paid.

- Transfertë në Llogari (duhet zgjedhur kur kryeni për herë të parë një transfertë)
- Transfertë e regjistruar (mund ta zgjidhni nëse keni kryer më parë transfertë në të njëjtin numër llogarie)

Transfertat brenda Vendit janë aktive pas dy ditë pune.

11.4 Ndërkombëtare

Këtu ju mund të kryeni transferta nga llogaria juaj drejt një llogarie tjetër të hapur në një bankë tjetër të nivelit të dytë jashtë Shqipërisë. Për këtë trasfertë ju duhet të ndiqni hapat e mëposhtme:



Zgjidhni një nga opsionet e mëposhtëm:

1. **Tranfertë në Llogari**, kur tranferta po kryhet për herë të parë në një numër llogarie
2. **Tranfertë e Regjistruar**, kur në të njëjtin numër llogarie është kryer më parë një transfertë

Nëse keni zgjedhur **Transfertë në llogari**:

- Zgjidhni tipin e transfertës:

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me **SWIFT**:

- Plotësoni shumën që doni të transferoni
- Zgjidhni monedhën e transfertës
- Vendosni kodin SWIFT të Bankës Pritëse
- Zgjidhni Shtetin e Bankës Pritëse
- Vendosni emrin e Bankës Pritëse
- Vendosni numrin e llogarisë pritëse
- Vendosni emrin dhe mbiemrin e personit të llogarisë përfutuese
- Numrin e telefonit të personit të llogarisë përfutuese

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me **IBAN**:

- Plotësoni shumën që doni të transferoni
- Zgjidhni monedhën e transfertës
- Vendosni kodin IBAN të llogarisë në të cilën do të kryhet transferta.
- Zgjidhni Shtetin e Bankës Pritëse
- Vendosni emrin e Bankës Pritëse
- Vendosni kodin SWIFT të Bankës Pritëse
- Vendosni emrin dhe mbiemrin e personit të llogarisë përfutuese
- Numrin e telefonit të personit të llogarisë përfutuese

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me **Emrin e Bankës Pritëse** (në këtë rast sigurohuni që të dhënat janë të sakta):

- Plotësoni shumën që doni të transferoni
- Zgjidhni monedhën e transfertës
- Zgjidhni Shtetin e Bankës Pritëse
- Vendosni emrin e Bankës Pritëse
- Vendosni adresën e Bankës Pritëse
- Vendosni qytetin e Bankës Pritëse
- Vendosni kodin e Bankës Pritëse
- Vendosni numrin e llogarisë pritëse
- Vendosni emrin dhe mbiemrin e personit të llogarisë përfituese
- Plotësoni numrin e telefonit të pritësit

Pasi të keni plotësuar të dhënat e lartpërmendura sipas zgjedhjes së tipit të transfertës duhet të:

- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transferta. (Sigurohuni që llogaria e zgjedhur të ketë gjendje të mjaftueshme për shumën e transfertës)
- Shkruani një përshkrim për transfertën
- Zgjidhni kategorinë e qëllimit të transfertës
- Zgjidhni qëllimin e transfertës
- Zgjidhni nëse doni të përdorni limitin e overdraft për të vazhduar me transfertën (nëse keni një limit overdraft të aktivizuar)
- Zgjidhni kategorinë e klientit pritës
- Zgjidhni se cili do të jetë personi që do të ngarkohet me pagesën e komisionit. Ju mund të zgjidhni një nga opsionet:
 - o Nëse zgjidhni opsionin e parë, detyrimet e bankës suaj i mbulon vetë dhe përfituesi mbulon detyrimet e bankës së tij
 - o Nëse zgjidhni opsionin e dytë, të gjitha detyrimet do t'i mbulojë pritësi
 - o Nëse zgjidhni opsionin e tretë, të gjitha detyrimet do i mbulon ju
- Klikoni "VAZHDO" për të kaluar në faqen e termave dhe kushteve, nëse jeni dakort me termat dhe kushtet klikoni "PRANOJ" për të vazhduar me transfertën,
- Nëse keni pranuar termat dhe kushtet do t'ju shfaqet faqja konfirmuese ku mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike
- Nëse të dhënat janë të sakta klikoni butonin "VAZHDO"
- Nëse doni të ndryshoni të dhënat klikoni butonin "ANULLO"
- Për të vazhduar konfirmoni të dhënat e kartës duke vendosur PIN-in e kartës që keni zgjedhur dhe më pas klikoni "KONFIRMO"
- Mandatin e transfertës mund ta gjeneroni/ ruani/ printoni ose ta dërgoni në adresën e postës suaj elektronike.

Nëse keni zgjedhur **transfertë e regjistruar**:

- Zgjidhni nga lista njëren nga tranfertat dhe automatikisht do të shfaqen të dhënat e transfertës së regjistruar.
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transferta
- Zgjidhni opsionin nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse keni një limit të aktivizuar)
- Nëse doni të ndryshoni ndonjë informacion, vendosni informacionin e dëshiruar.
- Zgjidhni se cili do të jetë personi që do të ngarkohet me pagesën e komisionit dhe në faqen konfirmuese mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike
- Klikoni Vazhdo për të përfunduar transfertën

11.5 Transferta të Regjistruara

Këtu do të shfaqet lista e transfertave të regjistruara, që ju keni kryer më parë. Duke zgjedhur njëren prej tyre ju mund ta fshini atë nga lista e Transfertave të Regjistruara që ju shfaqet në nënmenutë e transfertave.

11.6 Historiku i Transfertave

Këtu do të shfaqet historiku i transfertave që keni kryer. Kërkoni duke vendosur datën e fillimit dhe datën e përfundimit të kërkimit dhe do t'ju shfaqet lista e transfertave për periudhën e kërkuar.

12 PAGESAT

Nëse klikoni tek Menu **Pagesat** do ju shfaqen 5 nënmenu:

1. Pay TV
2. Rimbushje Celulari
3. Gjobat e trafikut
4. Doganat
5. Faturat

12.1 Pay TV

Këtu ju mund të shihni ose paguani këstet e marrëveshjes së lidhur me operatorin Digitalb, për të verifikuar vlefshmërinë e kontratës:

- Vendosni numrin e kontratës
- Klikoni VERIFIKO

Për të kryer pagesën e kësteve duhet të ndiqni hapat e mëposhtme:

- Zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma e këstit, Klikoni VAZHDO
- Zgjidhni nëse pranoi ose jo Kushtet e marrëveshjes (lexojini me kujdes), klikoni PRANOJ (nëse i pranoi) dhe më pas VAZHDO
- Në faqen konfirmuese mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike dhe klikoni VAZHDO për të përfunduar veprimin

Nëse doni që këstet e radhës të merren automatikisht nga llogaria juaj, duhet të Zgjidhni opsionin "Konfirmoj që unë jam dakort me pagesën automatike mujore për këstet e marrëveshjes me Digitalb"

12.2 Rimbushje Celulari

Këtu ju mund të rimbushni një numër celulari me parapagesë për operatorët Albtelecom Mobile, Vdafone Albania dhe Telekom Albania duke ndjekur hapat e mëposhtme:

- Zgjidhni operatorin e numrit celular që doni të rimbushni
- Zgjidhni Shumën e rimbushjes
- Plotësoni numrin celular sipas formatit të kërkuar, klikoni VERIFIKO
- Zgjidhni nëse doni të aktivizoni një nga ofertat për operatorët Albtelekom Mobile ose Vdafone Albania
- Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të merret pagesa
- Zgjidhni opsionin nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft-it (nëse keni një limit të aktivizuar)
- Zgjidhni nëse pranoi ose jo kushtet e marrëveshjes për pagesën (lexoni me kujdes), klikoni PRANOJ (nëse jeni dakord) dhe më pas VAZHDO


- Në faqen konfirmuese mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike dhe klikoni VAZHDO për të përfunduar veprimin

12.3 Gjobat e trafikut

Këtu ju mund të paguani gjobat e trafikut të cilat janë të regjistruara në sistemin e Drejtorisë së Policisë.

Kërkimin mund ta kryeni në 2 mënyra, duke:

- Zgjedhur **Numrin e Targës së makinës** (ku ju duhet të plotësoni Numrin e Targës dhe Numrin e Shasisë) dhe klikoni VAZHDO
- Zgjidhni nga lista gjobën që doni të paguani
- Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të kryhet pagesa
- Zgjidhni opsionin nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse keni një limit të aktivizuar)
- Klikoni VAZHDO, shihni me kujdes të dhënat e pagesës në faqen konfirmuese dhe më pas klikoni VAZHDO për të kryer pagesën
- Zgjedhur **numrin e Gjobës** (ku ju duhet të plotësoni numrin e serisë së gjobës) dhe do të shfaqet vetëm gjoba me numrin e serisë përkatëse bashkë me statusin e paguar ose jo, nëse nuk është e paguar, klikoni Vazhdo dhe më pas:
 - Në faqen pasardhëse do t'ju shfaqen detajet e gjobës, nëse janë të sakta klikoni VAZHDO
 - Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të kryhet pagesa
 - Zgjidhni opsionin nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse keni një limit të aktivizuar)
 - Klikoni VAZHDO, shihni me kujdes të dhënat e pagesës në faqen konfirmuese, ku mund të zgjidhni nëse detajet e pagesës t'i dërgoni në postën tuaj elektronike dhe më pas klikoni VAZHDO për të kryer pagesën



12.4 Doganat

Këtu ju mund të paguani detyrimet ndaj doganave në Shqipëri (nëse jeni të regjistruar më parë në Sistemin Doganor)

Pagesa kryhet duke:

- Vendosur numrin personal (të cilin e gjeni në kartën tuaj të identitetit)
- Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të merret pagesa
- Zgjidhni opsionin nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse keni një limit të aktivizuar)
- Klikoni VAZHDO, shihni me kujdes të dhënat e pagesës në faqen konfirmuese, ku mund të zgjidhni nëse detajet e pagesës t'i dërgoni në postën tuaj elektronike dhe më pas klikoni VAZHDO për të kryer pagesën

12.5 Edukimi

Këtu ju mund të paguani tarifat e universiteteve.

Pagesa kryhet duke:

- Zgjidhni një shkollë për të cilën doni të kryeni pagesën nga lista
- Zgjidhni tarifën që doni të paguani
- Vendosni numrin personal të kartës së identitetit
- Vendosni Emrin e studentit për të cilën po kryhet pagesa
- Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të merret pagesa
- Vendosni shumën e pagesës
- Vendosni përshkrimin e pagesës
- Zgjidhni opsionin nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse keni një limit të aktivizuar)
- Klikoni VAZHDO, shihni me kujdes të dhënat e pagesës në faqen konfirmuese, ku mund të zgjidhni nëse detajet e pagesës t'i dërgoni në postën tuaj elektronike dhe më pas klikoni PËRFUNDO për të kryer pagesën

12.6 Faturat


Nëse klikoni tek Menu **Faturat** do ju shfaqen 4 nënmenu:

1. Pagesë fature
2. Autorizimet
3. Faturat me autorizime
4. Faturat e paguara

12.6.1 Pagesë fature

Këtu ju mund të kryeni pagesat e faturave të Institucioneve me të cilat BKT ka një marrëveshje, duke:

- Zgjedhur kategorinë e Institucionit lëshues të faturës që doni të paguani
- Automatikisht do t'ju listohen Institucionet për kategorinë e Zgjedhur, Zgjidhni Institucionin lëshues të faturës
- Vendosni të dhënat sipas formatit të kërkuar, klikoni VAZHDO
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të merret pagesa e shumës
- Zgjidhni faturën që doni të paguani
- Vendosni përshkrimin (opsionale)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse ka)
- Klikoni VAZHDO, shihni me kujdes të dhënat e pagesës në faqen konfirmuese, ku mund të zgjidhni nëse detajet e pagesës t'i dërgoni në postën tuaj elektronike dhe më pas klikoni VAZHDO për të kryer pagesën




Nëse BKT nuk disponon të dhëna mbi faturat e institucionit përkatës, ju duhet të ndiqni hapat:

- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të merret pagesa e shumës së faturës
- Plotësoni të dhënat e kërkuara mbi faturën përkatëse
 - o Numrin e faturës
 - o Numrin e shërbimit (opsionale)
 - o Shumën që doni të paguani
 - o Datën e faturës
 - o Përshkrimin (opsionale)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft-it (nëse ka)
- Klikoni VAZHDO, shihni me kujdes të dhënat e pagesës në faqen konfirmuese, ku mund të zgjidhni nëse detajet e pagesës t'i dërgoni në postën tuaj elektronike dhe më pas klikoni VAZHDO për të kryer pagesën

12.6.2 Autorizimet

Këtu ju mund të krijoni, modifikoni dhe mbyllni një marrëveshje për pagesë automatike ose manuale të faturave sipas institucionit të zgjedhur.



Për të **krijuar** një autorizim të ri duhet të ndiqni hapat e mëposhtme:

- Zgjidhni nga lista nërmjet shigjetave anash Institucionin për të cilin doni të krijoni një autorizim
- Vendosni të dhënat përkatëse sipas formatit të kërkuar
- Zgjidhni një llogari nga lista e llogarive tuaja në BKT, nga e cila do të merret pagesa e faturave
- Zgjidhni periudhën e autorizimit
 - o **Pa limit** (pa një datë të caktuar për vlefshmërinë e autorizimit)
 - o **Me afat** (deri në një periudhë të caktuar nga klienti, përzgjedhja do të kryhet në bazë mujore)
- Zgjidhni tipin e pagesës:
 - o **Automatike**, nëse doni që pagesa e faturave të kryhet automatikisht nga llogaria juaj çdo muaj
 - o **Automatike e limituar**, nëse doni që pagesa e faturave të kryhet automatikisht nga llogaria juaj çdo muaj, deri në një shumë të zgjedhur nga klienti
 - o **Manuale**, nëse doni që pagesën ta kryeni personalisht nga Dega Internet ose BKT Smart
- Zgjidhni Datën e pagesës (e cila është e vlefshme për pagesat automatike)
- Zgjidhni mënyrën e njoftimit
 - o Njofto mbërritjen e faturës me email
 - o Njofto pagesën e faturës me email
 - o Njofto pagesën e faturës me SMS
- Pranoni ose Kushtet e marrëveshjes (lexojini me kujdes) dhe në faqen konfirmuese shihni me kujdes të dhënat dhe klikoni VAZHDO për të përfunduar veprimin

Shënim: Autorizimi hyn në fuqi në muajin pasardhës.

Për të **modifikuar** një autorizim do të ndiqni hapat:

- Zgjidhni autorizimin që doni të modifikoni. Modifikimet që mund të kryhen janë:
 - o Llogaria nga ku doni të kryhet pagesa
 - o Kohëzgjatjen e autorizimit
 - o Tipin e pagesës
 - o Datën e pagesës
- Pas modifikimeve të kryera klikoni VAZHDO, në faqen konfirmuese shihni me kujdes të dhënat dhe klikoni VAZHDO për të përfunduar veprimin

Për të **mbyllur** një autorizim do të ndiqni hapat:

- Zgjidhni autorizimin që doni të mbyllni
- Klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese shihni me kujdes të dhënat dhe klikoni VAZHDO për të përfunduar veprimin

12.6.3 Faturat me autorizime

Këtu do të shihni listën e faturave për pagesën e të cilave keni një autorizim aktiv si dhe detajet e saj:

- o Institucionin
- o Emrin e Abonentit
- o Numrin e Abonentit
- o Numrin e Faturës
- o Datën e Faturës
- o Shumën e Faturës
- o Datën e faturës
- o Statusin e Faturës (e paguar ose jo, nëpërmjet Degës Internet ose BKT Smart)

Nëse Tipi i pagesës është manual, ju mund të kryeni pagesën e faturës së zgjedhur duke:

- Zgjedhur llogarinë nga e cila do të merret pagesa e shumës, klikoni VAZHDO
- Zgjidhni në faqen konfirmuese nëse doni ose jo që kjo pagesë t'ju dërgohet në postën tuaj elektronike dhe më pas klikoni VAZHDO për të përfunduar veprimin

12.7 Pagesat e Kryera

Këtu ju mund të merrni informacion mbi çdo faturë të paguar nëpërmjet Degës Internet ose BKT Smart, sipas periudhës të zgjedhur nga ju me detajet përkatëse:

- o Numrin e referencës
- o Shumën e faturës
- o Institucionin lëshues së faturës
- o Datën e pagesës
- o Operatorin
- o Numrin e faturës
- o Datën e lëshimit të faturës
- o Numrin e abonentit
- o Detajet e pagesës nga ku ju mund të dërgoni informacionin në adresën tuaj elektronike ose ta shkarkoni/printoni atë

13 KREDITË

Nëse klikoni tek Menu **Kreditë** do ju shfaqet 1 nënmenu:

13.1 Kreditë e mia

Këtu ju mund të shihni informacionin si mëposhtë:

- o Listën e Kredive aktive dhe të likujduara në BKT
- o Numrin e kontratës së kredisë
- o Datën e fillimit të kontratës së kredisë
- o Datën e mbylljes së kontratës së kredisë
- o Shumën dhe monedhën e kredisë
- o Shumën e pakthyer të kredisë
- o Statusin e kredisë

14 INVESTIMET

Nëse klikoni tek Menu **Investimet** do ju shfaqen 3 nënmenu:

1. Këmbimi valutor
2. Kursi këmbimit
3. Bonot e mia të thesarit

14.1 Këmbimi valutor

Këtu ju mund të kryeni këmbimin valutor në monedhat e ofruara nga BKT. Për të kryer këmbimin e dëshiruar ju duhet të keni një llogari në monedhën që doni të kryeni këmbimin. Sipas zgjedhjes, shumat e konvertuara automatikisht kalojnë në gjendje në llogaritë e zgjedhura.

Këtu ju mund të kryeni:

- **Blerje Valute** (nga llogaria juaj në Lek shuma e konvertuar kalon gjendje në llogarinë e monedhës së huaj të zgjedhur)
- **Shitje Valute** (nga llogaria juaj në monedhë të huaj, shuma e konvertuar kalon gjendje në llogarinë tuaj në Lek)

- **Këmbim Valutash** (nga llogaria në monedhë të huaj, shuma e konvertuar në një monedhë tjetër të huaj do të kalojë gjendje në llogarinë e monedhës të fundit të zgjedhur).



14.2 Kursi këmbimit

Këtu mund të shihni kursin e këmbimit mbi monedhat e listuara.

14.3 Bonot e mia të thesarit

Këtu do të shihni listën e kontratave tuaja të Bonove të Thesarit në BKT dhe do ju shfaqet informacioni mbi:

- o Numrin e kontratës
- o Datën e fillimit
- o Datën e maturimit
- o Shumën
- o Normën e Interesit
- o Statusi i kontratës
- o Interesin përkatës

Këtu mund të shkarkoni listën e kontratave në format excel ose PDF.

15 PERSONALIZIME

Nëse klikoni tek Menu **Personalizime** do ju shfaqen 2 nënmenu:

1. Personalizime
2. Informacione

Zgjidhni që kjo menu të shfaqet direkt tek menutë e preferuara



Këtu gjeni një përshkrim mbi këtë menu

Klikoni këtu që t'ju shfaqet menu Personalizime

15.1 Personalizime

Në këtë nënmenu ju do të shihni 4 nënmenu të tjera:

- Ndryshim Fjalëkalimi
- Limitet e veprimeve
- Pulla Dixhitale
- Kufizim Llogarie

15.1.1 Ndryshim Fjalëkalimi

Këtu mund të ndryshoni fjalëkalimin tuaj për hyrjen në Degën Internet (ndryshimi mund të kryhet nëse mbani mend fjalëkalimin aktual), sipas kriterëve të mëposhtme:

- Fjalëkalimi mund të përmbajë karaktere alfanumerike
- Fjalëkalimi duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere
- Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV)
- Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të vazhdueshëm (psh. 111111, 123456)

15.1.2 Limitet e veprimeve

Këtu mund të ndryshoni limitet mbi veprimet bankare që doni të kryeni nëpërmjet Degës Internet ose BKT Smart. Në kutitë përkatëse do të shfaqet limiti maksimal për transaksion dhe ditor, ky limit mund të ulet ose rritet (nëse është ulur më parë nga klienti), por nuk mund të tejkalohet.

15.1.3 Pulla Dixhitale

Këtu mund të ndryshoni pullën dixhitale e cila do ju shfaqet sa herë që të hyni në Degën Internet ose ne BKT Smart.

15.1.4 Kufizim Llogarie

Këtu mund të zgjidhni llogaritë që nuk doni të kryeni veprime nëpërmjet Degës Internet ose BKT Smart.

15.2 Informacione

Në këtë nënmenu ju do të shihni 4 nënmenu të tjera:


- Deklarimi të Ardhurave
- Njoftime të zgjuara
- Informacion Kontakti
- Informacion Personal

15.2.1 Deklarimi të Ardhurave

Këtu do të shfaqen përfitimet që keni marrë nga interesat e produkteve në BKT.

15.2.2 Njoftime të zgjuara

Këtu mund të shihni listën e njoftimeve të dërguara në telefonin tuaj celular ku keni hyrë për herë të fundit në BKT Smart, gjithashtu mund të zgjidhni nga lista e veprimeve të kartave dhe llogarive tuaja, veprimet për të cilat doni të merrni njoftimin, si mëposhte:



Zgjidhni që kjo menu të shfaqet direkt tek menutë e preferuara

Këtu gjeni një përshkrim mbi këtë menu

Këtu zgjidhni veprimet për të cilat doni të njoftoheni në BKT Smart


Këtu mund të kërkonit njoftimet e mëparshme

Këtu do të shihni listën e njoftimeve të dërguara në telefonin tuaj celular

Këtu do të shkoni para ose pas sipas numrit të njoftimeve

Këtu do të shihni detajet e njoftimit të zgjedhur

Data	Ora	Përshkrimi
22-01-2019	14:06:30	Transfertat brenda BKT
22-01-2019	09:48:30	Transfertat brenda BKT
18-01-2019	19:38:24	Blerje Me Karte Krediti
18-01-2019	14:08:23	Blerje Me Karte Krediti



Njoftime të zgjuara

Menutë e Preferuara

Konfigurimet e Njoftimeve

- Transfertë brenda BKT**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me Transfertat nga klientë të BKT
- Depozitim i Keshit**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me Depozitimet e Keshit në llogari
- Transfertë nga Kosova**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me Transfertat nga Kosova
- Transfertë nga banka të tjera**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me Transfertat nga Banka të tjera
- Blerje nga POS Shqipëri**
Dëshiroj të marr njoftime për blerje në POS Shqipëri nga karta e kreditit dhe e debitit
- Blerje nga POS jashtë Shqipërisë**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me blerjet në POS-et jo në Shqipëri
- Blerje në Internet**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me blerjet online
- Pagesë e kartës nga të tjerë**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me pagesat e Kartës së Kreditit nga dikush tjetër
- Tërheqje me/nga karta**
Me njofto për tërheqjet nga ATM me kartat e mia dhe prekjen e Cash limit të kartës së kreditit.
- Pagesë Fature**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me Pagesat e Faturave
- Pagesë automatike me Debitim Direkt**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me pagesat e Debitimeve Direkte
- Kreditim page në llogari**
Dëshiroj të marr njoftime në lidhje me kreditimin e pagës në llogari

☒ Do dëshiroja të merrja njoftime në formë shoqërore

☒ Njoftohuni Para Identifikimit

[< Kthehu](#) [Ruaj >](#)

15.2.3 Informacion Kontakti

Këtu mund të ndryshoni adresën e postës suaj elektronike

15.2.4 Informacion Personal

Këtu mund të ndryshoni adresën tuaj të banimit që doni të keni si kontakt për bankën (adresa e banimit duhet të ketë vetë shkronja dhe numra, **nuk** duhet të ketë karaktere speciale)

16 DALJE

Banka Kombetare Tregtare Sh.a [AL] | <https://ebank.bkt.com.al/ebanking/homepage.html>

BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE

Menutë e Preferuarat

Mirëdita !

Personalizime
Kontakti
Dalje

Faqja Kryesore

Asetet
509,848 ALL

Gjendja e Disponueshme
459,848 ALL

Limiti Disponueshëm i Kartës
35,625 ALL

Kursi i Këmbimit

Monedha	Blerje	Shitje
AUD	75.900	76.500
CAD	82.450	83.750
CHF	100.700	110.400
EUR	121.500	122.200
GBP	134.900	137.050
TRY	17.990	20.105
USD	108.100	109.100

Veprimet e Fundit

Veprimi	Shuma	Time
Tërheqje nga ATM	5,000.00 ALL	2019-07-05
Pagësi Future	1,000.00 ALL	2019-07-05
Transferat Hyrës	200.00 ALL	2019-07-05
Tërheqje nga ATM	3,000.00 ALL	2019-07-03
Pagësi Future	5,000.00 ALL	2019-07-03

Kalendar
KOR, 2019

05/07 Transferat Hyrës
200.00 ALL

05/07 Pagësi Future
1,000.00 ALL

05/07 Tërheqje nga ATM
5,000.00 ALL

Fito një iPhone X

Regjistrohu ose kryej transaksione në BKT Smart dhe bëheshi automatikisht pjesë e listës.

3 trena gjatë 2019

Banka Kombetare Tregtare Copyright © 2019

Hytja e Fundit:
04.07.2019 10:36 AM

Shfaq

Klikoni "DALJE" për të dalë nga Dega Internet